



RAPORTI NËNTËMUJOR I PUNËS

JANAR-SHTATOR

2024

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Tetor 2024

 REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA 
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine
-XII- Br. 273 10.10.24
RAHOVEC - ORAHOVAC

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr.06/L-024 për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe Statuti të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Raport në bazë të punëve të cilat janë realizuar në periudhën Janar-Mars 2024 nga Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Në kuadër të Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë,

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit,
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Të hyrat buxhetore në DUPMM (nëntë mujorin) për vitet 2022-2023-2024

Viti	2022	2023	2024
Të hyra Janar-Mars	28,233.54	41,973.56	47,1

Kërkesat për nëntë mujorin për vitet 2022-2023-2024

Janar- Mars	2022	2023	2024
Leje Ndërtimore	37	56	54
Leje Mjedisore	15	25	23
Kushte Ndërtimore	53	91	66

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në tre mujorin e parë të vitit 2024 zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve.

Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç' rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

JANAR – SHTATOR 2024					
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hudhet
Leje ndertimi	54	50		3	1
Leje rrenimi	6	5			1
Leje përdorimi	2	2			
Kushte nderimore	66	45	11	9	1
Shkrese	78	72		5	1
Vertetim	57	54	1	2	
Legalizim	16	9		7	
GJITHËSEJ	279	237	12	26	4

Të hyrat e përgjithëshme Janar - Mars –2024

Parallogaria	36,6991.95 €
Legalizim	4,111.51 €
Vertetim –Pelqim	4,015.00 €
Totali I të hyrave	45,118.46 €

SEKTORI I MJEDISIT

Në bazë të Sektorit të mjedisit leshojmë Leje mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

Janar – Shtator 2024					
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hudhet
Leje Mjedisore	23	20	3	0	0

Të hyrat e përgjithëshme në Sektorin e Mjedisit Janar - Shtator –2024

Leje Mjedisore	2238.54 €
-----------------------	------------------

Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031

Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, është një dokument multisektorial i cili përcakton kahet e zhvillimit të komunës për 8 vitet e ardhshme. Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, është miratuar.

Vlersimi Strategjik Mjedisor VSM për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032 ka kaluar në fazën e shqyrtimit publik. Ai është dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për t'u pajisur me pëlqim për miratim.

Hartën Zonale 2024-2032

Harta Zonale e Komunës paraqet ndarjen precize të territorit të komunës në zona funksionale dhe për secilën zonë përcakton shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për periudhën e planifikuar të zhvillimit. Draft dokumenti është pregaditur pas marjes së pëlqimit nga ministria për VSM-en, do vazhdojë me procedurat.

Ndërtimi i Sheshit Qëndror në Qytet

Sheshi Qëndror është projekti më i madh që është realizuar ndonjëherë në Komunën e Rahovecit. Përmes këtij projekti, synojmë të krijojmë qasje në hapësira publike të sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, me veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta. Gjithashtu, synohet krijimi i mundësive të reja për biznes dhe rritja e cilësisë së jetës urbane.

Punimet po vazhdojnë me ndërtimin e unazës brenda sheshit, e cila do të lidhë katër rrugë dhe do të krijojë një qasje më të mirë për qytetarët. Në gjysmën e nëntorit pritet të funksionalizohet parkingu nëntokësor dhe rruga.

Shënimi i Ditës së Tokës

Me moton 22.04.2024 u shënu Ditës së Tokës me disa aktivitete: Mbajllja e luleve në qytetun e Rahovecit dhe në fshatra, pastrimi vullnetar i rrugëve, pastrimi i mjedisit përreth objekteve shkollore, pastrimi i varrezave të dëshmorve, liminimi i deponive ilegale.

U mbajtë gara me nxënsit e shkollave fillore të komunës me punimet kushtuar dites se tokes tri vende te para jan shberblyer. Shetitje me biçiklista në qytet bashke me OJQ-ë “KOKRAT”.